

VENDIM
Nr.1522, datë 12.11.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I PIKËS SË
KALIMIT KUFITAR BLLATË/PESHKOPI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve, z.Mexhit Muça dhe z.Gani Muça, të pasurive të paluajtshme, pronë private, tokë/arë, me nr.pasurie 155/1 dhe 155, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, që preken nga ndërtimi i pikës së kalimit kufitar Bllatë/Peshkopi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, për sipërfaqen 1015 (një mijë e pesëmbëdhjetë) m², tokë/arë, të vlerësuar me çmimin 673 lekë/m², për zonën e Peshkopisë, përkatësisht: Mexhit Muça, për sipërfaqen 210 (dyqind e dhjetë) m², me 141 330 (njëqind e dyzet e një mijë e treqind e tridhjetë) lekë;

- Gani Muça, për sipërfaqen 805 (tetëqind e pesë) m², me 541 765 (pesëqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 518 000 (pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 683 095 (gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë, të përballohet nga “Llogaria speciale”, e krijuar si transfertë kapitale, për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.11.2008 dhe të përfundojë me 30.12.2008.

7. Afati i punimeve të ndërtimit të fillojë brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi dhe të përfundojë brenda 12-muajve.

8. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe ZRPP-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha

GEN - PLAN

Shkalla: 1 : 2500

Iertimi i Prones DOGANA BELLATË
 Pronari SHTETI
 Adresa BELLATË, KOMUNA HADELLARË
 Indeksi i Hartes H-34-B9/(80-D)
 Zona KADASTRALË 1224
 Zëri kadastral TRUALL

Siperfaqja totale _____ m²
 Siperfaqja ndertesës _____ m²
 Zene me paisje elektrike _____ m²
 Siperfaqja funksionale _____ m²
 Siperfaqja jashte rrethimit _____ m²



Rilevoi dhe hartoi

Top. G. Lazri

Licënsë nr. 12.0539/10
 GAFOR LIZNI
 Nr Lic 12.11544

Kryetari i fshatit

(HAJRI MUSA)

KRYETARI I KOMUNES

(BARONYL AGOLLË)

